

SHTYLLAT E IMANIT

Përkufizimi imanit sipas pasuesve të sunetit dhe xhematit është:

- a. besim me zemër,
- b. shqiptim me gjuhë,
- c. veprim me gjymtyrë,
- d. shtohet me bindje ndaj Zotit, dhe
- e. pakësohet me mëkate ndaj Tij.

Shtyllat e imanit

Shtyllat e imanit janë gjashtë:

1. Besimi në Allahun.
2. Besimi në melekë.
3. Besimi në Librat e Allahut.
4. Besimi në të dërguarit e Allahut.
5. Besimi në Ditën e Gjykimit.
6. Besimi në kader (paracaktimin e Allahut).

Argumenti

Argument për shtyllat e imanit e kemi hadithin e Xhibrilit, alejhis-selam, kur ai e pyeti Pejgamberin Muhamed, sal-lallahu alejhi ue sel-lem, duke thënë:
“Më trego për imanin.” Ai tha: “Imani është të besosh në Allahun, në melekët, në librat e Tij, në të dërguarit, në Ditën e Fundit dhe të besosh në paracaktimin (kaderin), të mirën dhe të keqen e tij.”
 (Shënon Muslimi)

Vini re!

Ai që nuk beson në ndonjërin nga këto shtylla nuk mund të jetë musliman.